



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



KONTRATA

Me datë 19.07.2019 në mes të:

KOMUNA E PRISHTINËS, rruga: UÇK 2, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë dhe

"**N.P.T. " MALI-I "**" nga Mitrovica –adresa :Mitrovice rruga e Ulqinit, me numër të regjistrimit të biznesit 810201400 dhe me numër fiskal 601208871 përfaqësuar nga Majlinda Bajraktari– Drejtoresh në tekstin e mëtejme ("Kontraktuesi"), janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS: "Furnizimi me kolltuk per nevojat e BPZ –se"

Numri i Prokurimit: 616 19 109 121

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë "**Furnizimi me kolltuk per nevojat e BPZ –se**"

1.2 Kontrata hynë në fuqi me *[shëno daten]* dhe përfundon me *[shëno daten]*.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **20 ditë** nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi do të jetë *Brigada e Zjarrfikësve*.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **4.329,80€**; (Kater mijë e treqindë e njëzet e nënëtë euro e tetëdhjet cent).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borx Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale te pagesës pas pranimit të tërë dërgesës]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkuesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i [furnizimeve] duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të [furnizimeve]

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose te gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuar deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marra e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjeter ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjeter ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhere, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *[specifiko gjykatën kompetente]* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen *[Shqip]*² në katër origjinalë, tri origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.


Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	<i>MILINDA BASHKARIAJ</i>	Emri:	Zekë Bardhaj
Pozita:	<i>MENAXHER KOGUMI</i>	Pozita:	Udhëheqës i Departamentit te Prokurimit
Nënshkrimi:	<i>M. BASHKARIAJ</i>	Nënshkrimi:	<i>Z. BARDHAJ</i>
Data:	<i>10.07.2017</i>	Data:	<i>19.07.2019</i>
Vula:	 <i>MALI-I</i> <i>MITROVICË</i> 	Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Nr	Specifikacioni teknik - Kolltuk -fotele	SASI A(Copë)	Çmimi per njesi	TOTALI
	Përmasat e kolltukut pa ambalazhim <ul style="list-style-type: none"> Lartësia e ulëses : 44 cm Lartësia e krahut : 73 cm Thellësia e ulëses : 75 cm Gjerësia : 80 cm Thellësia e kolltukut : 80 cm Lartësia e kolltukut : 85 cm Gjerësia e brendshme e ulëses : 58 cm Gjerësia e krahut : 11 cm Pesha : 30 kg Volumi : 0.55 m³ 	23	188.25	4329.75
	Përmasat e produktit me ambalazhim <ul style="list-style-type: none"> Gjerësia : 85 cm Thellësia : 85 cm Lartësia : 90 cm Pesha : 31 kg Volumi : 0.65 cm³ <p>Detajet e materialit</p> <ul style="list-style-type: none"> Kategoria e copëzës : habana Ngjyra : Blu e errët Materiali : 100 % poliester Pesha : 500 gr/m² Rezistencë ndaj ujit Përbërja e brendshme : dru ahu me lagështi më të vogël se 11% Sfungjeri : 5500 me densitet 32 kg/m³ Llastik për tapiceri kolltukësh: 470 F Këmbët e kolltukut : druri ose metal Sasia e këmbëve : 4 copë Lartësia e këmbëve : 12 cm 			
			TOTALI	4329.8



N.P.T.
"MALI-I"
 MITROVICE

NPT "MALI-I"

NRB: 71128792

MITROVICË

KONTAKT:044 746 641

Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

DEKLARATË E LIFERIMIT



Nr. i Prokurimit ²	616-19-4137-1-3-6
Nr i brendshëm	616 19 109 136

Titulli: Furnizimi me kolltuk per nevojat e BPZ-së

Deklarojmë me pergjegjësi të plotë morale dhe juridike se **furnizimet** Furnizimi me kolltuk per nevojat e BPZ-së do të behën brenda asfatit që është -20- ditë nga nënshkrimi i kontratës me AK-së.

Sinqerisht,

MAJLINDA BAJRAKTARI


..... 48.06.2019

N.P.T.
"MALI-I"
MITROVICË

NPT "MALI-I"

NRB: 71128792

MITROVICË

KONTAKT: 044 746 641

Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

DEKLARATË

PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Nr. i Prokurimit ³	616-19-4137-1-3-6
Së fëmijeshmëm	616 19 109 136

Titulli: Furnizimi me kolltuk per nevojat e BPZ -se

Deklarojmë me përgjegjësi të plotë morale dhe juridike se Furnizimi me kolltuk per nevojat e BPZ -se do të jenë në përputhje të plotë më kërkosat të cilat janë përaktuar në specifikacionin teknik për mallrat e ofruara të cilat do te përputhen me ato të përmendura në **Aneksin 1 të dosjes së tenderit**. Si dhe te pjesa II përshtrimi i çmimeve ne dosjen e tenderit.

Sinqerisht,

MAJLINDA BAJRAK TARI

..... 18.06.2019

